



01 Nr. 306/26 Dt. 14.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g) Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Ligjit nr. 02/L-118 për Emrin Personal, Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin dhe emërimin e Komisionit për zbatimin e procedurës për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për zbatimin e procedurës për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal për shtetasit e Republikës së Kosovës nga Zyrtarët e Gjendjes Civile në Komunën e Prizrenit. Komisioni përbëhet nga:

- 1.1. Riza Kryeziu,..... kryesuese,
- 1.2. Iljaz Krasniqi,.....anëtar,
- 1.3. Arbënore Gërmizaj,.....anëtare,
- 1.4. Ajdin Ljimi,.....anëtar rezervë.

2. Detyrat e Komisionit, të emëruar si në pikën 1 e këtij Vendimi janë të përcaktuara në Ligjin nr. 02/L-118 për Emrin Personal, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi.
3. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi 01 nr. 491/25, i datës 08.08.2025.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Administratës-Spektori i Gjendjes Civile dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Komisionit,
 - MPB,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

